



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 51 datë 30-03-2026

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2,615,046 LEKË PËR
BLERJE KARBURANTI PËR EMERGJENCAT CIVILE**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 2,615,046 lekë për blerje karburanti për emergjencat civile”, duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 14.1.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, si dhe VKB nr. 27 datë 25.2.2026 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2025 të Bashkisë, institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2026”, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e fondit prej 2,615,046 lekë për blerje karburanti për emergjencat civile, për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET Prog. AB122 00	V091AAD	01 Art. 6060000	- 2,615,046 lekë (Bashkia)
SHTOHET Prog. AE122 00	V626AAD	01 Art. 6020000	+ 2,615,046 lekë (NSHP)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

Miratuar me 22 vota
Vota Pro 22
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 30-03-2026

KRYETAR
Ana Verushi